

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 03.09.2025, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Gusht 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen. Sot kemi mbledhjen e radhës të muajit gusht me këtë rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Korrik 2025”
2. Projekt-Vendim “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit Vendor për Barazi, Përfshirje, dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2030”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028”
7. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025””
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Njësine Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë “Për dhënien në përdorim pa kundërshtpërblim dhe pa afat të objektit “CASA OLA”, në Lezhë në funksion të krijimit të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor””
9. Projekt-Vendim “Për korrigjimin e VKB nr. 68, datë 29.07.2025 “Për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Rruga e Kishës” në “Motër Carmela Cataldo” dhe të marrë emrin “Nënë Karla Borgeri””
10. Informacion nga Bashkia Lezhë mbi realizimin e buxhetit për 7-mujorin e vitit 2025
11. Të ndryshme

Kush është dakord me rendin e ditës? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 22 vota Pro. Faleminderit.

Dua të sqaroj që në këtë mbledhje përveç përfaqësuesve të drejtorive të bashkisë që kanë të bëjnë me projektvendimet e sotme, kemi dhe dy përfaqësues nga qendra H.A.N.A. Sa për dijeni, qendra H.A.N.A ka pasur disa rekomandime në lidhje me projektvendimin për planin vendor për sistemin e arsimit parauniversitar, kështu që kur t'i vijë radha do flasim për këtë.

Vazhdojmë me projektvendimin e parë “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Korrik 2025”. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 22 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.

Ky është një projektvendim që është pothuajse për të gjitha bashkitë e republikës. Kush ka ndonjë gjë nga bashkia mund ta thotë por sa për dijeni ngarkohet kryetari i bashkisë, i cili harton pastaj edhe planin e kësaj marrëveshjeje. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 22 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës, Projektvendim “Për miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028”

Në lidhje me projektvendimin, shkurtimisht, pasi ka qenë dhe relacioni, fjalën e ka drejtoresha e Shërbimit Social.

-Marte Feta: Përshëndetje të gjithëve. Siç e dini, një ndër detyrat funksionale të drejtorisë së shërbimit dhe kujdesit social është përgatitja e planeve sociale, planeve strategjike me të cilat drejtoria e shërbimit social do të punojë gjatë gjithë viteve të ardhshme. Gjatë gjithë kësaj periudhe, specialistët e drejtorisë së shërbimit dhe kujdesit social kanë punuar në mënyrë shumë të avancuar me të gjithë target grupet me të cilat ne punojmë për të krijuar dhe për të përgatitur planin social. Vijnë para jush pasi kemi zbatuar të gjitha hapat ligjorë për të bërë këtë plan social. Na ka dhënë një ndihmë Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, e cila kërkoi që të gjitha bashkitë të paraqiten dhe të bëjnë planin social, pavarësisht se Bashkia e Lezhës planin social e kishte të përgatitur deri në fund të vitit 2025. Ne kemi bërë planin social për 2026-2028, i cili është një protokoll ose një dokument që paraqitet në duart e shërbimeve sociale për të pasur dhe për të garantuar cilësinë e dhënies së shërbimeve të gjithë target grupit me të cilët ne punojmë, për të zgjeruar shërbimet e reja dhe për të forcuar ato shërbime të cilat kemi. Arsyeja për të krijuar apo për të kërkuar projekte të reja, i duhet Bashkisë së Lezhës që të ketë planin social për të thithur fonde nëpërmjet të gjitha organizatave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duhet plani social. Gjatë gjithë kësaj periudhe që kemi punuar, kemi evidentuar të gjitha nevojat që target grupet me të cilat punojnë çdo ditë me ne kanë shprehur nevojat e tyre dhe i kemi parashtruar në këtë dokument të cilin e kemi paraqitur pranë jush edhe në konsultimin publik ku gjej rastin të falenderoj disa anëtarë këshilli që atë ditë ishin me ne, ku në mënyrë të detajuar e kemi paraqitur të gjithë planin social, gjithashtu dhe te Komisioni i Barazisë Gjimore dhe Shërbime Sociale që ishim dje, pavarësisht se nuk ishin shumë persona në komision, kemi paraqitur me detaje të gjitha dokumentet, gjithashtu edhe një kërkesë me të cilën e ka paraqitur anëtarja e këshillit që ishte prezente në dëgjuesën

publike, i kemi kthyer përgjigje me shkrim Këshillit Bashkiak, të cilët të gjitha ato kërkesa që zonja ka bërë janë të paraqitura në një mënyrë në planet tona si në planin social ashtu në planin e barazisë gjinore edhe në planin për përfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian. Projektet e reja me të cilat Bashkia e Lezhës na bën krenar, me të cilët do operojmë në vitet e ardhshme, është qendra e moshës së tretë, ku shumë shpejt Bashkia e Lezhës pret për të nënshkruar kontratën me donatorin e huaj të Kosovës, Halil Kastrati, për të bërë një qendër model. Gjithashtu në planin tonë social ne kemi shkruar edhe përhapjen që do shumë shpejt në 2026 kemi për krijimin e një çerdheje të re e cila do na ndihmojë. Jemi në përpunimin e projektit për ta hapur dhe për ta ristrukturuar një çerdhe të re që do të plotësojë të gjitha nevojat që Bashkia e Lezhës ka, pasi momentalisht jemi vetëm me një çerdhe. Kemi kërkuar dhe kjo është një protokoll me të cilin ne kërkojmë fonde edhe nga buxheti i Bashkisë edhe nga donatorët për të krijuar qendra të reja edhe në njësitë administrative ku kudo që janë target grupet tona t'ju shkojnë shërbimi pranë njësite administrative. Unë jam e gatshme për çfarëdolloj pyetje që të keni nevojë me ju kthy përgjigje.

-Ndue Luli: Faleminderit, kush ka pyetje diskutim? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Në fakt kam marrë pjesë edhe kam ndjekur dëgjesat publike të zhvilluara me datë 20 gusht në lidhje me planet vendore që shtrohen për diskutim sot edhe aty kam parashtruar disa problematika sipas sektorëve të trajtuar gjatë diskutimeve. Duke marrë nxitje edhe nga komunikimi me qytetarët, por edhe gjatë diskutimeve aty, lindën propozime mbi problematika të ndryshme. Sa i përket planit vendor social, siç edhe e theksoi edhe Marta, disa ndër problemet që kam parashtruar si të domosdoshme për t'u përfshirë në prioritetet e Bashkisë Lezhë, duke u nisur nga fakti që ky plan vendor social që ne shtrojmë për diskutim sot është për dy vitet, pra 2026 deri në 2028, janë sa vijon: së pari unë mendoj, jo vetëm unë, por banorët e Lezhës, se tashmë ka ardhur koha dhe është domosdoshmëri që Bashkia e Lezhës të mundësojë ambiente të reja me infrastrukturën e duhur për akomodimin e qendrës së zhvillimit ditor. Kjo do të mundësonte jo vetëm trajtimin dinjitoz të personave që marrin trajtim apo që frekuentojnë më saktë këtë qendër, por edhe kushte më të mira për stafin që u shërbejnë personave me aftësi ndryshe që trajtohen pranë kësaj qendre. Kësisoj unë mendoj që ky projekt duhet të ishte përfshirë në prioritetet 2026-2028 të propozuara nga Bashkia Lezhë. Së dyti, kam propozuar që Bashkia Lezhë duhet të shtojë vëmendjen sa i përket infrastrukturës në shërbim të personave me aftësi ndryshe në lidhje me aksesueshmërinë e tyre në rrugë apo në objekte të ndryshme. Thënë ndryshe, duhet të mundësohen në kushte optimale infrastrukturore rampat, por pra krahas korrigjimit të infrastrukturës ekzistuese, duhet që Bashkia Lezhë ta vërë si kusht të panegociueshëm që çdo objekt i ri që ndërtohet të jetë i shoqëruar edhe me infrastrukturën në shërbim të personave ndryshe. E them këtë, sepse ne të gjithë shohim se jo vetëm objektet ekzistuese, në masë dërmuese, nuk e kanë këtë infrastrukturë, por edhe objektet e reja që ndërtohen nuk e kanë këtë infrastrukturë shoqëruese. Sa i përket planit vendor social, kam kërkuar që Bashkia Lezhë duhet të avancojë procedurat për të bërë të mundur premtimin e parashikuar dhe të miratuar në buxhetin e këtij viti për të ndërtuar qendrën rezidenciale ditore në shërbim të moshës së tretë. Kjo do t'i shërbente moshës së tretë në qytetin e Lezhës, por pse jo

për ta shtrirë këtë si eksperiencë edhe në bashki, në njësitë administrative si fillim, me numrin më të lartë të banorëve. Një tjetër pikë, unë e kam theksuar që Bashkia e Lezhës, të paktën 10 vitet e fundit, e kam theksuar edhe në muajt e fundit, gjatë konsultimeve, të paktën në 10 vitet e fundit, shërbimet sociale i ka patur, si element kryesor të përfaqësimit të saj, Lezha jo vetëm në nivelin e qeverisjes vendore, por edhe në institucionet e tjera në nivel rajonal, por edhe duke marrë parasysh organizata të ndryshme, ka krijuar tashmë një rrjet të konsoliduar të shërbimeve sociale. Edhe Bashkia Lezhë në këtë pikë ka detyrimin që ta fuqizojë këtë rrjet duke dhënë mbështetje, sidomos edhe ndaj organizatave të cilat veprojnë në territorin e bashkisë. Kaq sa i përket planit social, ndërkohë për propozimet e tjera do t'i referoj gjatë pikave të tjera të rendit të ditës. Faleminderit.

-Ndue Luli: Zonja drejtoreshë.

-Marte Feta: Në fakt të gjitha këto që Alfrida tha, po ja lejoj vetes të flas me emër, meqë më foli, ja kam kthyer dhe me përgjigje dhe me shkrim. Përsa i përket qendrës së zhvillimit ditor, unë i kam kthyer përgjigje dhe i kam thënë se me kabinetin e kryetarit të bashkisë ne jemi në diskutim dhe jemi në proces për gjetjen e ambienteve sa më të përshtatshme dhe sa më të mira, por duke ditur se është shumë e vështirë për të gjetur ambiente të tilla, që nuk lejohen që të jenë në bazë të standardeve, nuk lejohen që të jenë afër qendrave, pallateve të banimit apo afër shkollave, jemi në diskutime dhe duke parë se ku mund të gjejmë një ambient të përshtatshëm për qendrën e zhvillimit ditor. E kam kthyer dhe me përgjigje që çdo ditë që mblidhemi me nënkryetarët, ne diskutojmë dhe jemi duke parë gjithë stafi i drejtorisë rajonale të qendrës së zhvillimit ditor, jemi në kërkim se ku mund të gjejmë një ambient të përshtatshëm. Përsa i përket organizatave, Bashkia e Lezhës, besoj se jeni në dijeni që ne kemi edhe programin Reload, ku prioritet është fuqizimi i organizatave lokale dhe ne të gjithë, është viti i dytë që japim sponsorizim nga bashkia dhe kanë qenë organizatat lokale ato të cilat kanë dalë fituese për të dhënë shërbimin, siç e kanë pasur vjet shërbim në ndihmë të grave dhe vajzave në nevojë, veçanërisht ato të rasteve me dhunë në familje.

-Alfrida Marku: Vetëm një shtesë në fakt që më kaloi gjatë arsyetimit, në pikat e rendit të ditës, ndër të tjera ne shohim një marrëveshje, miratimin e memorandumit të mirëkuptimit midis Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë dhe Bashkisë Lezhë për të vënë në dispozicion objektin, dua të arsyetoj se ku mund ta gjejmë, ku mund të jetë një objekt i mundshëm për qendrën e zhvillimit ditor. Është e rëndësishme që edhe qendrës për kujdesin shëndetësor mendor ne t'i kushtojmë vëmendjen e duhur, por në linjën e diskutimit që parashtrova, ambientet e Casa Ola, në mendimin tim, mund të jenë, në fakt janë ambiente të arsyeshme, shumë të përshtatshme, që të rishikohen për t'u vënë në shërbim të qendrës së zhvillimit ditor. Faleminderit.

-Ndue Luli: Vazhdojmë, ka mendim tjetër? Po.

Po në fakt e kemi pikë të rendit të ditës, kështu që kur t'i vijë rasti po e diskutojmë.

-Marte Feta: Vetëm për planin social edhe një gjë, qendra moshës së tretë, që këshilltarja tha qendër rezidenciale ajo nuk është qendër rezidenciale, por është qendër ditore me të gjithë kapacitetet.

-Ndue Luli: Mirë atëherë, ka ndonjë mendim tjetër? Po zoti kryetar.

-Erdhi këshilltari Zek Doda.

-Pjerin Ndreu: Qendra e moshës së tretë, qendra ditore, është në përfundim, në kalkulim, madje unë pretendova se mund të shkojmë të shtunën me një grup këshilltarësh për të vizituar atë qendrën në Suharekë, që është një model që me pa diçka ndryshe që ka bërë po e njëjta shoqatë. Nuk e di Renisi a ka konkluduar përfundimisht për termat e marrëveshjes, jemi ulur një ditë edhe kemi rënë dakord për të ndryshuar disa gjëra, termat e marrëveshjes, jemi gati me nënshkru marrëveshjen, ata janë gati pastaj me fillu punë menjëherë mbasi ta kalojmë në këshill marrëveshjen, por paraprakisht do të shkojmë ne me një grup këshilltarësh, kuptohet nga gjithë forcat politike që të jenë prezentë edhe të shohin se çfarë reputacioni ka zotëria që vjen dhe çfarë ka bërë që mos të them pastaj jo po kështu jo po ashtu se ai do hedhë le të themi 2 milionë euro për të bërë atë qendër. Plus do hedhë edhe bashkia pjesën e vet. Mendoj se bashkë me ata mund të akomodojmë edhe disa procese të tjera përveç moshës së tretë. Ajo që është lidhet me QZHD-në është një pikë për t'u diskutuar dhe mund të akomodojmë këtu, mund të shikojmë një variant tjetër, por gjithsesi edhe sot në mëngjes e kemi diskutuar me stafin e ngushtë që ajo qendër duhet të shikohet që të gjendet një mundësi tjetër për QZHD-në, kështu që kjo është në fund, atëherë do hyjmë në procesin tjetër pastaj që do miratojmë në këshill dhe do fillojmë lëvizjen e gjithë banesave që janë dhe meqë jam në mbledhje të këshillit nuk ka absolutisht asnjë lloj dileme, ata do të lëvizin të gjithë dhe kjo është e ligjshme sepse kanë uzurpuar pronën publike aty, e para, e dyta e kanë të palegalizuar, e treta, ne do t'i mbështesim me bonus qeraje, i japim mundësinë, ja ku ke o zotëri, bonus qeraje, te kreditë e buta mund të hyjnë dhe të akomodohen, ua kemi dhënë alternativat, kaq është detyra jonë si pushtet lokal, kështu që nuk ka edhe njëherë publikisht, nuk ka as edhe një dilemë, aty do të ndërtohet qendra, një ndër qendrat më të mira në Shqipëri të moshës së tretë, multifunksionale ditore, dhe të gjithë ata banorë duhet të përgatiten të dalin prej aty.

-Ndue Luli: Faleminderit, mendim tjetër nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin, ju lutem kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 23 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 4, Projekt-Vendim "Për miratimin e Planit Vendor për Barazi, Përfshirje, dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030"

Shkurtimisht, zonja Marta.

-Marte Feta: Atëherë, për krijimin e planit për barazinë dhe përfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian, ishte një plan i domosdoshëm për t'u bërë nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, pasi vjen njëkohësisht dhe me planet edhe strategjitë kombëtare që ka Ministria e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me organizatën Drejtësia Sociale e cila punon ngushtësisht me komunitetin rom dhe egjiptian, stafi i Drejtorisë së Shërbimit të Kujdesit Social ka punuar me të gjithë target grupet për përfshirjen e tyre. Një ndër pikat kryesore me të cilat ky plan vjen dhe që është domosdoshmëri për t'u zhvilluar dhe për të dhënë qasje në vitet e ardhshme është gjithëpërfshirja e tyre në arsim, gjë e cila nëpërmjet këtij plani ne kemi përfshirë disa drejtori pas konsultimeve që kemi bërë siç është ZVA-ja dhe të gjitha drejtoritë që punojnë ngushtë për këto dhe qendrat tona komunitare me të cilat ne momentalisht kemi dy qendra komunitare që punojnë për komunitetin rom dhe egjiptian, arsimimin e tyre dhe pas shkollën e tyre. Kemi marrë kontakt dhe me Caritasin Shqiptar i cili ka marrë qendrën e cila është qendra që ka pasur drejtuar Luciana Levri dhe kanë dhënë sigurinë që kanë shkruar një projekt në Romë dhe shumë shpejt kemi një lajm të mirë deri në fund të këtij viti për rihapjen e kësaj qendre. Tjetra pikë me të cilën ne kemi punuar ngushtësisht është sistemi i shëndetësisë ku dihet se shumica e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian nuk marrin asistencë apo nuk bëjnë vaksinat. Kemi punuar me ta dhe kemi ndarë disa pika të veçanta ku hap pas hapi në fillim të vitit që do fillojë plani i ri, ne do krijojmë grupet tona në terren, tryezat teknike, njësinë e vlerësimit të nevojave, me të cilat do të evidentojmë të gjitha rastet e komunitetit rom dhe egjiptian që kanë nevojë për vaksinim, që kanë nevojë për arsim dhe që kanë nevojë për mbështetje ekonomike dhe sociale. Këta janë një target grup me të cilin te strehimi social 80% e familjeve që ne kemi i kemi të komunitetit rom dhe egjiptian. Kemi familje që kanë shumë nevoja ekonomike, jo më vonë po vetëm dy muajt e verës ne kemi mbështetur, kemi siguruar një maune me detergjentë dhe bebelina për të cilat kishin nevojë ky komunitet, pako ushqimore, që Bashkia e Lezhës jep çdo muaj 100 pako ushqimore për familjet kryesore që përfshihen te ndihma që jep drejtorja jonë janë familjet e komunitetit rom dhe egjiptian dhe të gjitha njësitë administrative. Dhe për fundvit dhe festat fetare të cilat mbështeten, ishte e domosdoshme ky plan social për arsyen se ne do aplikojmë në projekte të cilat do hapë ministria për komunitetin rom dhe egjiptian.

-Ndue Luli: Faleminderit, mendim tjetër? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin, ju lutem? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 23 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 5, Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2030”. Edhe ky është një nga projektvendimet që është bërë me konsultim publik me një pjesëmarrje të gjerë, siç ishin dhe të dy të parët. Në lidhje me këtë, shkurtimisht zonja Marta.

-Marte Feta: Pak a shumë shkurtimisht edhe ky, unë dua të falenderoj UN-in, është një organizatë ndërkombëtare e cila bën planet e barazisë gjinore në të gjithë Shqipërinë. Na është vetofruar dhe ka ndihmuar me asistent dhe ky është një plan që ka zgjatur përgatitja e tij gjashtë muaj dhe të gjitha drejtoritë e Bashkisë Lezhë kanë qenë prezent duke dhënë mendimet e tyre, ku një ndër pikat kryesore kemi përforcimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe punësimin për vajzat dhe gratë në të gjitha njësitë administrative, rritjen e përfaqësuesve dhe të grave dhe vajzave, veçanërisht për pjesëmarrje politike siç mund të kemi promovimin e tyre apo ndihmën e tyre me grupe të ndryshme për t'i orientuar drejt përfaqësimit të tyre siç është këshilli bashkiak

apo dhe në pjesë të tjera, nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave, integritet gjinor, politik për vajzat dhe gratë, por plani i barazisë gjinore nuk ngelet vetëm tek vajzat e gratë se këtu përfshihen edhe djemtë edhe burrat e të gjithë target grupet me të cilët punon, por është parë në lente gjinore, në të gjitha drejtoritë, për përfshirjen në taksa, për përfshirjen në infrastrukturë, për përfshirjen në të gjitha, në bujqësi, veçanërisht me gratë që kemi punuar në zonat rurale, ka dalë si nevojë të cilën e kemi përfshirë dhe në planin tonë për ndihmën e grave të cilat punojnë si fermere dhe në artizanat të cilat mund të përgatisin dhe ndoshta në një të ardhme Bashkia e Lezhës mund të krijojë mundësinë, e kemi përfshirë te plani, për t'u dhënë mundësi për të shitur produktet e tyre me të cilat ato punojnë.

-Ndue Luli: Kush ka mendim? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Në fakt, nëse ndihmojmë gratë, kemi ndihmuar më shumë sesa gjysmën e familjes, por nëse ndihmojmë gratë në nevojë, kemi bërë shumë më shumë sesa kaq. Edhe gjatë diskutimit të planit social për barazinë gjinore, disa ndër pikat për të cilat kam propozuar që mendoj se duhet të përfshiheshin në këtë plan janë: së pari, e shpreh mbështetjen për lehtësitë fiskale që parashikohen në këtë plan vendor sa i përket iniciativave në sipërmarrje të grave në nevojë, por unë mendoj që kjo nismë duhet të jetë shumë më e gjerë sesa kaq. Gratë dhe vajzat në nevojë do të jenë subjekte të përjashtimit të detyrimeve vendore, jo vetëm si taksapagues, nëse ato ndërmarrin një iniciativë biznesi, sipërmarrje, por edhe si qytetarë, edhe si familjarë, pra, të kemi një përjashtim absolut të përgjithshëm nga të gjitha detyrimet vendore, për gratë dhe vajzat në nevojë. Është premtuar, në fakt në buxhetin e këtij viti edhe është miratuar nga Këshilli Bashkiak që bashkia duhej të mundësonte disa tregje në zona të caktuara, në njësi administrative të caktuara, me qëllim që të bëhej e mundur tregtimi i produkteve të zonës, por duke u lidhur me këtë plan social, unë mendoj që Bashkia Lezhë duhet të bëjë të mundur tregjet e posaçme për t'i dhënë akses grave të zonave të ndryshme për të trajtuar prodhimet e tyre dhe kjo do të krijonte mundësi për fuqizimin ekonomik të këtyre grave, për fuqizimin ekonomik të këtyre familjeve, por pse jo dhe për promovimin e produkteve të zonës. Një tjetër çështje që lidhet në fakt me punësimin edhe me fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, që lidhet edhe me pjesën e planit, me pikën gjashtë të rendit të ditës, me planin e arsimit parauniversitar, është që përpara se të diskutojmë se gratë duhet të punojnë si kusht i domosdoshëm për fuqizimin ekonomik të tyre dhe pavarësinë e tyre, ne duhet, pra Bashkia Lezhë ka detyrimin që t'u krijojë kushte grave që të akomodojnë fëmijët e tyre në çerdhe dhe në kopshte. Të gjithë e dimë, është fakt aq më tepër që jemi dhe në fillim të vitit të ri shkollor edhe parashkollor, që në të gjitha njësitë administrative, por në mënyrë të veçantë është emergjente në qytetin e Lezhës, mungesa e çerdheve në kapacitetin e duhur për akomodimin e fëmijëve sipas kërkesave që qyteti i Lezhës tashmë ka, pra njësi administrative tashmë ka, shtuar këtu faktin që shumë banorë vijnë nga njësitë administrative për të jetuar në Lezhë, por Lezha tashmë është bërë zonë e mirë për jetesë edhe nga qytetarë të bashkive të tjera, pra është emergjente, është e domosdoshme që Bashkia Lezhë të marrë masa për shtimin e hapësirave apo ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve të reja me qëllim që t'u vijë në ndihmë familjeve në Njësinë Administrative të Lezhës dhe në të

nëntë njësitë e tjera administrative, por sidomos nënave duke krijuar mundësi në këtë mënyrë edhe për punësimin e tyre. Faleminderit.

-Ndue Luli: Po zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Një mendim se tashmë u bë pak si e rrugës kjo lloj pune, se po marr shumë indicie edhe këtu nga këshilli edhe nga zonja këshilltare që merr një listë të gjatë kështu dhe fillon kështu edhe nga disa organizata joqeveritare që kujtojnë se jetojmë në kohën e mrekullive dhe gjithçka duhet ta bëjmë në perfeksion. Mos harrojmë se jemi në vitin e parë buxhetor pa borxh dhe po monitorohemi këtë vit nëse do e mbajmë ritmin apo s'do e mbajmë. Kjo do të thotë që në kompjuter nuk mundesh me shpik një, dy, tre gjëra: politika rinie e politika grash, politika sociale të thella që ne nuk i përballojmë dot nga ana e buxhetit. Atëherë t'i heqim investimet të gjitha dhe t'i kalojmë atje dhe të fokusohemi aty, gjë që është e pamundur. Edhe investimet publike që bëjmë ne, që janë në fakt në fluks shumë të lartë dhe do vazhdojnë në një fluks akoma më të lartë tani e mbrapa dhe me buxhetin që do bëjmë ne, do të thotë që i shërbejnë në një mënyrë a në një tjetër, i shërbejnë cilësisë së jetesës dhe përmirësimit të disa aspekteve. Se kam parë një material, domethënë sikur me e marrë Gjermaninë do thotë fillon edhe tundet pak, që ta shohë një herë, seriozisht, duhet të bëhen këta. Unë e di se duhet të paguhen disa politika, disa stimulime, disa gjëra, po t'i bëjmë me radhë, të konsolidojmë financat e bashkisë njëherë, të konsolidojmë mënyrën e funksionimit të bashkisë. Sivjet, ne jemi në një monitorim të disa gjërave që duhet të ndajmë njëherë mirë shapin nga sheqeri në funksionimin e një bashkie, do funksionojë me ritëm dhe me realizim buxheti, me planizim dhe realizim buxheti real, ku ne shkojmë me mbi 90%. Ne jemi ndër bashkitë më të mira në realizimin e buxhetit, në katër bashkitë më të mira vitin që kaloi, por sivjet do të jemi edhe më mirë dhe jemi duke e parë dhe jemi duke u kujdesur për planizimin. Pra ne duhet të shkojmë njëherë, kemi shumë, shumë aspekte pa shëruar dhe ne nuk mund të hyjmë në politika luksi. Normalisht që duhen, mund të çohet ndonjëri dhe të argumentojë, të shkruaje ca email-e nëpër ca donatorë. Se do t'u kthehem dhe atyre donatorëve, i kam kapur unë ca dizinformacione që shkruajnë, gjëra të paqena që shkruajnë, i kemi kapur. Nuk lejoj askënd, as organizata joqeveritare, askënd që dizinformojë donatorët, sepse donatorët janë institucion, i çoj një material tjetër, i them hajde verifikojë, edhe pastaj fondet e këtyre shkojnë në zero. Po ne nuk mund të bëjmë luftë të brendshme këtu me përralla kompjuterash. Pra mora shkas nga ju që mos të fantazojmë, le të ulemi me këmbë në tokë, dhe të bëjmë atë që duhet të bëjmë. Në qoftë se konstatohet që fondet po i çojmë kështu kuturu, ajo është problem tjetër pastaj. Ore zotëri, ti ke planizuar këtë, këtë, por më duket se nuk po shkojnë në destinacionin e duhur dhe atëherë po ne këtu për këtë punë jemi. Po nëse ne fillojmë në kompjuter dhe shohim prit njëherë se kemi një politikë sociale dy, pesë, shtatë, tetë që Gjermania do i kishte zili, dakord do them unë po duhen, po problemi është se ne nuk e kemi luksin akoma të njësie vendore me kapacitete financiare të atij niveli. Si më vjen më tregon ca politika rinore që ne kemi hapur rrugët me shumë të rinj i kemi suportuar edhe si bashki, edhe kur kanë pasur bursa, edhe kur kanë pasë aktivitete, gjithmonë. Tashi jo po ti merr edhe bizneset, bëj edhe këta, paguaj edhe këta, paguaj dhe ato, avash njëherë se jemi në Shqipëri, jemi në

Shqipëri. Nëse unë, nëse më le ti mua që ta bëj, unë bëj djalin tim biznesmen, dal unë atje, djali im s'paguan, këto gjërat zigzakët shqiptare, unë nuk mundem me i promovu, kështu që i bëjmë hap pas hapi. Mos të fantazojmë në kompjuter, fantazitë në kompjuter nuk janë për ne, qartë dhe saktë. Në qoftë se doni pastaj dalim me argument, edhe ju gjej unë argument të OJF-ve lezhjane që dizinformojnë donatorët, dhe materialin e kemi ne aty me dizinformacione të qarta, për me kriju idenë te donatorët se ne jemi duke bërë diçka kështu. Sepse e dini se deri vjet ishim me borxhë apo s'e dini, apo s'ka problem domethënë se ne këshilli i luajmë lekët, nuk i shpik kush tjetër, merre një lek prej këtu e çoje këtu, unë s'kam gjë në dorë, unë jap piketat bashkë me stafin tim një dy tre 10, vijmë këtu themi jo kjo jo ajo, e zgjata pak se është bërë rrugë kjo, po një modë që kanë gabuar, kanë shkelur në dërrasë të kalbur.

-Ndue Luli: Mendim tjetër, ka kush? Nuk ka. Kush është dakord me projekt vendimin, ju lutem kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 23 vota Pro, faleminderit,

-U largua këshilltari Alfons Trashaj.

-Ndue Luli: Kalojmë te pika 6, Projekt-Vendim "Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028". Në lidhje me projektvendimin, fjalën e ka shkurtimisht drejtori i arsimit, duke pasur për bazë edhe disa rekomandime, mendime që janë dhënë edhe nga qendra H.A.N.A, fjala për ju.

-Keler Sufja: Po faleminderit, është hera e parë për mua që jam në këshill bashkiak, kështu që e vlerësoj edhe interesin e gjithsecilit këtu, specifikisht vlerësoj dhe interesimin e qendrës H.A.N.A dhe është mirë që organizata joqeveritare apo edhe partnerë aleatë, qytetarë të përgjegjshëm marrin përsipër që të jenë aktiv dhe të angazhohen edhe të përfshihen, pra mos të jetë vetëm një rol i këshillit bashkiak ky, por edhe qytetarëve të zakonshëm të përgjegjshëm që përfshihen, shumë faleminderit. Në fakt unë besoj që gjithsecili prej anëtarëve e ka pasë në dorë, ka lexuar dhe materialin dhe falenderojmë edhe shoqatën e bashkive të cilat janë angazhuar dhe na kanë ndihmuar, sepse në dijeninë time është hera e parë që bëjmë një plan mirëfilli për arsimin po themi për vitet 2026-2028, po unë do kisha dashur me mirëkuptimin tuaj, të ndalem vetëm te disa pika që pikërisht qendra H.A.N.A ka sjellë në vëmendje se çfarë mund të përfshihet apo do duhet të përfshihet te ky plani jonë arsimor kështu që unë mbase do shkoj pikë për pikë për të tentuar me qenë shterrues, gjithsesi edhe për qendrën H.A.N.A pastaj e kam materialin që t'i kthejmë përgjigje në rrugë zyrtare edhe dorazi, por gjithsesi të ndalem te dy tre pikat që janë më kryesore për t'i shterruar edhe në praninë tuaj. Qendra H.A.N.A ndalet në disa pika, një prej tyre është mungesa e transparencës, sipas tyre në mbledhjen e përdorimit të kontributeve vullnetare nga prindërit nëpër shkolla, edhe në dijeninë tonë në bazë edhe të urdhrin të ministrisë së arsimit numër 25 datë 25/7/2018 për ngritjen në funksionimin e bordit të institucioneve arsimore, është detyrë e bordit të shkollës, pra në asnjë rast drejtoria arsimore nuk ndërhyt edhe nuk përfshihet, ju e dini pastaj më mirë sesa unë ndoshta si funksionon bordi i shkollës, ku ka të përfshirë po themi, edhe një anëtar të drejtorisë së arsimit.

-Ndërhyn Kryetari i Bashkisë, duke thënë që nuk ka lidhje me aktivitetin e Bashkisë Lezhë.

-Keler Sufja: Një tjetër kërkesë është adresimi i mungesës së rojeve në shkollat zonale dhe rurale. Bashkia Lezhë në fakt ka emëruar një roje në gjimnazin “Hydajet Lezha”, i cili është edhe si shkolla me numrin më të lartë të nxënësve si dhe katër roje të tjera në shkollat e qytetit të cilat kanë numër po të lartë, gjithsesi, godinat arsimore në fakt një pjesë e madhe e tyre, sidomos edhe në njësitë administrative, Bashkia Lezhë ka vendosur kamera monitoruese, por në asnjë rast edhe roja në fakt që bashkia vendos atje është për të ruajtur ambientin, në asnjë rast nuk është drejtpërdrejt për të ruajtur po themi, sigurinë e nxënësve, ajo bëhet nga policimi në komunitet edhe janë struktura totalisht të tjera që nuk varen drejtpërdrejt nga drejtoria arsimore për pasojë nga Bashkia Lezhë. Gjithsesi Bashkia Lezhë ka dhe një projekt që të plotësojë të gjithë institucionet arsimore, edhe ato që kanë numër të vogël nxënësish, edhe ato që janë në njësinë më të largët, me kamera vëzhguese, në këtë mënyrë do jetë edhe më e monitorueshme edhe sidomos me dëmtimet që kemi nëpër shkolla, që është një temë tjetër shumë rëndësishme për ne, që do na lehtësojë punën.

-U largua këshilltari Emanuel Perjaku.

-Pjerin Ndreu: Të bëj unë një sqarim tjetër këtu, e para e punës njëherë, kjo çështja e rojeve nuk është një problematikë për t'u diskutuar, sepse ne nuk kemi një problematikë nga shkolla. Sot kam bërë takim unë me drejtorët e shkollave, sepse mungesa e rojës në një shkollë, ku mund të ketë kamera, ku mund të mos ketë, që në fakt fluksi i problematikave të shkollave është pothuajse afër zeros, në kuptimin e dëmtimit a vjedhjes a sulmit nga jashtë, pothuajse është inekzistent, pra dhënia e fondeve me vu roje për çdo shkollë është kosto që rëndon mbi taksapaguesit lezhjanë dhe ne nuk mund të vendosim një shërbim pa një studim dhe pa një arsye se roja nuk ruan nxënësit brenda. Nuk është ky standard në asnjë vend të Shqipërisë, në asnjë vend të botës, ose mundet shkolla ta paguajë me fondet e veta, në qoftë se e sheh të arsyeshme, me të ardhurat e veta dhe e bën, s'është çështje, çështja bëhet kur ne kemi një problematikë të ripërsëritur, të ricikluar, një dinamikë ngjarjesh, të cilat na vënë në krizë dhe themi, po jemi të detyruar të hyjmë në një variant tjetër, diku hyjmë me kamera, diku hyjmë me roje, diku se s'marrin vesh, diku thërrasin policinë e shtetit në bashkëpunim, diku të gjitha, është një gjë që nuk bëhet kështu, gjej një pyetje tjetër dhe bëje, kjo është gjej një pyetje dhe bëje, pa argument, mbi ç'bazë, kush është arsyeja, kush është situata, s'ka ndonjë, unë nuk di ndonjë feedback nga shkollat që ne të kemi problematikë se s'është roja këtu dhe aty bëhet nami, s'ka ndodhur.

-Ndue Luli: Po drejtor.

-Keler Sufja: Një tjetër pikë është transporti i nxënësve dhe mësuesve, një tjetër pikë ku drejtpërdrejt drejtoria arsimore nuk përfshihet, Bashkia e Lezhës cakton linjat e transportit, por nuk ka lidhje me ne drejtpërdrejt.

-Pjerin Ndreu: Shkurt, s'ka lidhje me ne, këtu jemi në këshill bashkiak dhe do flasim për problematika që na ngarkojnë ne si bashki.

-Keler Sufja: Jemi munduar me qenë shterrues edhe nga ana ligjore, kryetar.

-Pjerin Ndreu: Keler, nuk ka lidhje me ne, pikë.

-Keler Sufja: Nevoja për depolitizimin e faqeve online të shkollave të ZVAP Lezhë, tjetër pikë që s'ka lidhje me ne, ekzistenca dhe pajisja e laboratorëve të TIK, kimisë, fizikës dhe të çdo shkolle, sikur se kemi thënë më lart, drejtorja arsimore vetëm garanton mirëmbajtjen e ambienteve të shkollave. Rivendosja dhe transparenca e bursave të ekselencës, në asnjë rast nuk është drejtpërdrejtë detyrë e drejtorisë së arsimit të bashkisë, po drejtorja e arsimit të bashkisë ka një fond që ka edhe aktualisht si shpërblimet për 20 nxënësit më të mirë që është një gjë krejt tjetër që ne shumë mirë që e kemi por nuk ka lidhje me bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar. Dhe nevoja për objektiva të matshme dhe të mirëpërcaktuara në plan. Në fakt kjo është një pikë që ne mund ta diskutojmë paksa. Patjetër që po. Ajo që ne kemi bërë fillimisht është që kemi thënë po, drejtorja arsimore garanton edhe mirëmbajtjen e ambienteve të shkollave dhe pajisjen 24 orë me ujë, me drita, me ngrohje por nuk kemi shënuar pikë për pikë sa shkolla janë e si janë. Patjetër që po, mund ta bëjmë dhe konkretisht nëse doni që të ndalemi, një prej pikave ishte sigurimi i furnizimit pa ndërprerje të shkollave e të kopshteve për çdo njësi administrative të Bashkisë Lezhë përmes angazhimit të stafit të kualifikuar arsimor si dhe ofrimi i shërbimeve bazë si uji i pishëm, energjia elektrike, sistemi i ngrohjes, higjiena, ushqimi, pajisjet e tjera. Do bëhet, pra ne propozojmë që të bëhet një ndryshim edhe në bazë të sugjerimeve të qendrës H.A.N.A, sigurimi i furnizimit pa ndërprerje i 56 godinave të institucioneve arsimore, përmes sigurimit të shërbimit bazë të ujit të pishëm, energji elektrike, ngrohje dhe disponueshmëri të stafit të kualifikuar në përputhje me standartet kombëtare.

Një tjetër pikë që sugjerojmë që të ndryshohet ishte modernizimi i kapacitetit menaxherial dhe monitories të sistemit arsimor vendor nëpërmjet përmirësimit të të dhënave dhe dixhitalizimit të proceseve administrative për bashkëpunimin ndër-institucional, pra ne mendojmë që do ketë një platformë që do na ndihmojë në këtë aspekt dhe të bëhet, dixhitalizimi i të paktën 4 aspekteve administrative, frekuentim, burimet njerëzore, nevojat infrastrukturore dhe performancën e shërbimit të institucioneve. Në këtë mënyrë edhe drejtorja arsimore, edhe drejtorja e arsimit në bashki, edhe vetë nxënësit nëse do duan, të kenë një platformë të përbashkët ku ne të monitorojmë aktivitetin e shkollave, punën, klasifikimin, ecurinë apo edhe një rankim ndoshta të nxënësve sipas rezultateve që ata kanë.

Një tjetër pikë e cila ishte forcimi i shërbimit mbështetës për fëmijët me aftësi ndryshe, përfshirë psikologë shkollorë, punonjës social, mësues ndihmës, staf të specializuar, do të bëhet forcimi i sistemit mbështetës për fëmijët me aftësi ndryshe përmes psikologut, punonjësit social dhe shtimin e 5 mësuesve ndihmës të arsimit parashkollor. Është kjo problematika që e hasim në sektorë të ndryshëm, që jo gjithmonë ka kërkesë, por ne dhe te Burimet Njerëzore, rast pas rasti

bëjmë shpalljen në faqen eeb të Bashkisë Lezhë dhe aty pastaj marrim gjithë aplikimet, kërkesat, që më pas ne të kemi mundësi t'i implementojmë.

Dhe e fundit, ishte promovimi i pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete jashtë mësimore kulturore, artistike e sportive që mbështesin zhvillimin e tyre emocional, fizik dhe shoqëror, të bëhet rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve të moshës 6-18 vjeç, në aktivitetet jashtë mësimore kulturore, artistike, sportive dhe sociale me 30% deri në fund të vitit 2028, përmes organizimit të të paktën 14 aktiviteteve të shkollave për çdo vit. Shpeshherë jo vetëm drejtoria arsimore, por ë përgjithësi Bashkia Lezhë, sa i takon aktiviteteve të kësaj natyre, në fakt është që realiteti e tejkalon këtë, edhe nëpërmjet faqes zyrtare që është në Facebook, gjithsekush ka akses dhe e shikon qartë që shpeshherë Bashkia Lezhë bën aktivitete edhe përtej asaj që ka të programuar. Këtë e them me krenari, por nuk është për meritën time, është për meritë të Bashkisë Lezhë.

Kam dhe dy gjëra të vogla që lidhen me kërkesat që Alfrida, flas me emër meqë jemi shokë, i ka bërë më herët sa i takon edhe fokusit tonë që të jemi prezent me ngrohjen në mënyrë të vazhdueshme, me ujë apo me të gjithë elementët e tjerë sikurse e thashë, këtë gjë Bashkia Lezhë e ka bërë. Bashkia Lezhë vitin e fundit, jo vetëm që i ka mbuluar këto nevoja, por dhe i ka mirëadministruar se këshilli është mirë ta dijë këtë gjë , nëse flasim për dru, nëse flasim për pellet, e kemi rujt dhe kemi gjendje në magazinat e bashkisë që ditët që fillon sezoni dimëror, ende pa filluar blerjet, ne kemi gjendje, po të doni jua jap edhe me Shifra, kjo tregon punën e mirë, kjo tregon që ka njerëz të përgjegjshëm. Edhe një kërkesë tjetër të Alfridës, që lidhet me shtimin edhe nevojën e kopshteve , patjetër që po. Dy gjëra kam në lidhje me këtë, ne po shohim mundësinë edhe të planifikimit të një kopshti të ri ndoshta, një projekti të ri që mund të jetë në qytet, por aktualisht ne sapo jemi në përfundim të një grupi të ri te kopshti “Hirushja”, dhe kjo, në këtë moment, na ezauron të gjithë këtë listë sepse kemi pasë një listë pritjeje të prindërve që nuk kanë pasë mundësi me i akomodua fëmijët nëpër kopshte, ne, për grupin e ri që ngremë tani shpeshjt, mendoj që për 1-2 javë jemi gati, ne mbulojmë gjithë nevojën e kësaj listës së pritjes. Ndërkohë në të gjitha njësitë administrative janë marrë me të gjitha elementet, për t'u bërë nga fillimi parketi, ngrohja, dyert dhe dritaret apo edhe çatia në vende të caktuara, pra kopshtet në të gjithë njësitë administrative janë marrë në dorë një për një dhe ky është lajm i mirë. Ne po shikojmë mundësinë që të shtojmë njëkopsht në një prej njësive më të mëdha, në Shënkoll, jemi në diskutim dhe me Asetet për të parë nëse do gjejmë një ambient në pronë të bashkisë, është parë më herët, ka çaluar diku, se ne e dimë sa vështirë janë këto historitë e pronave në Shqipëri, sepse Shënkollë është një prej atyre njësive që e ka mundësinë që nënat me fëmijë dhe familjet në nevojë kanë një treg pune të mundshëm, sepse kanë Talen aty, kanë disa element, pra ne i japim një dorë me shtimin e këtij kopshti, patjetër i kemi dhënë një dorë familjeve në nevojë kryesisht, por edhe në përgjithësi, që të rrisin mirëqenien e tyre. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: Edhe një sqarim. Në jetën artistike, kulturore, sportive të nxënësve, të të rinjve janë bërë hapa gjigandë përpara por që nuk mjafton, gjithmonë ka diskutim. Pallati i Kulturës, QKF janë vënë në dispozicion të gjithkujt që ka një grup për të përgatitur me zero lekë. U kemi dhënë hapësirë të gjithë talentëve në teatro, pikurë, këmgë, balet, të shkollës “Besëlidhja” të bëjnë aktivitete free, me zero kosto, në sallën e pallatit të kulturës. Bashkia ka paguar talent shoë për shkollat 9-vjeçare çdo vit, ku janë evidentu dhe janë promovu talente të reja që i kanë shërby qytetit në disa zhanre. Janë aktivitete sportive të tjera. Zëmë vendin e parë në basketboll, morëm për 20-vjeçarët mos gaboj, vendin e parë, s`po them për të rriturit se aty s`kemi konkurrencë fare, dhe për 16 vjeçarët kemi 4 stimuj që ne i kemi mbështetur si bashki dhe kanë dalë të parët në vend. Plus që kemi mbështetur dhe vajzat e volejbollit. Gjithë talentet e reja të sportit janë të mbështetur me financë nga ne, duhet trajneri, e paguajmë ne. Paguajmë të gjithë sportistët që janë kampion me bonus. Nuk besoj ta ketë bërë ndonjë bashki në Shqipëri këtë lloj politike që kemi bërë ne. Nuk është sekret për ta thënë, tani jemi në konkludim të një projekti për futbollin. Mendoj se për pak ditë do dalim para publikut dhe do bëjmë platformën e zhvillimit të futbollit. Shumësportet ne i suportojmë të gjitha, trajnerët i paguajmë të gjithë, gjithë sportistët që janë kampion, që kanë rezultate të larta, ne i paguajmë, transportin, do bëjmë pallatin e sportit që na është premtu. Do jetë një tjetër risi, një tjetër mundësi, siç bëmë parkun, ku thuhej se do bëja pallate unë. Fantazitë pa lekë janë. Ke ndonjë gjë tjetër Jona?

-Jona Dividi, Dr. Kulturës: Në bazë të këtyre që ju kryetar sapo thatë, jo më larg se ditën e sotme, drejtoria e kulturës ka ngritur dhe është duke e hartuar një program për përfshirjen e të gjitha shkollave të njësive administrative që Lezha ka, që do të thotë jo vetëm pjesëmarrjen e të gjithë të rinjve të 9-vjeçareve dhe të gjimnazeve por gjithashtu dhe rivitalizimin e këtyre zonave, që do të thotë, ne do të shkojmë si grupe pune për të punuar me të gjithë të rinjtë që ne jo vetëm t`i stimulojmë për të punuar dhe krijuar, por gjithashtu të sjellin dhe aktivitete të ndryshme nëpër qendrat e këtyre njësive administrative. Së shpejti do ta kemi dhe programin gati.

-Erdhi këshilltari Agostin Marku.

-Pjerin Ndreu: Kemi dhe një program, Reload, që shumica e projekteve kanë shku aty, i kanë fitu organizata të ndryshme, janë marrë me artizanat, me të rinjtë, me shkollën, me aspekte të ndryshme, me programe artistike. E mira nuk ka fund. Puna është se ajemi duke bërë hapa para, ajemi duke bërë hapa pas. Nëse jemi duke bërë hapa para, hajde të ecim pak më shpejt, por jo të mbjellësh zi. Mos të gënjejmë.

-Ndue Luli: Kush e do fjalën tjetër në lidhje me p/vendimin? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Meqë jemi te pani vendor për arsimin, unë po e ritheksoj që pavarësisht përmirësimeve ndër vite në infrastrukturën e shkollave, kopshteve dhe çerdheve, Lezha ka domosdoshmëri dhe urgjencë shtimin e hapësirave për çerdhe dhe kopshte. Për t`u rikthyer te konsultimi në lidhje me planin vendor për arsimin parauniversitar, një ndër problemet që u shtrua nga drejtorë shkollash, ishte edhe që Bashkia Lezhë duhet të shtojë vëmendjen sa i përket

pajisjes së shkollave me mjete kancelarike, që kuptohet që do i lehtësonte ata në aktivitetin mësimor të përditshëm.

Për t'iu rikthyer çështjes së rojeve të shkollave që në fakt u konfondon pak me oficerin e sigurisë. Ne e dimë të gjithë se oficeri i sigurisë është tagër dhe detyrim i drejtorisë rajonale arsimore. Janë shtuar në këtë fillim viti shkollor edhe 5 oficerë sigurie në 5 shkolla të tjera, por jo të gjitha shkollat e Lezhës e kanë shërbimin e oficerit të sigurisë, edhe kjo është një diskutim i arsyeshëm, që ne duhet ta bëjmë me qëllim që të gjitha shkollat të pajisen me këtë shërbim. Unë nuk jam dakord me atë që u tha, nuk kemi probleme të referuara dhe nuk ka arsye që të shtojmë sigurinë, unë i qëndroji parimit që ne problematikave duhet t'u paraprijmë dhe për të dalë diku tjetër, në dhjetor të vitit të kaluar u zhvillua një mbledhje, mbledhja e këshillit të sigurisë në Bashkinë e Lezhës, e cila kishte në fokus pikërisht mbarëvajtjen e vitit shkollor dhe kryesisht sigurinë në shkolla, edhe këtu më lejoni që të propozoj, meqë jemi edhe në fillim të vitit të ri shkollor, Bashkia Lezhë duhet që të iniciojë apo të organizojë një takim të tillë me drejtues të shkollave, drejtues të institucioneve, përfshirë këtu drejtorinë vendore të policisë, prokurorinë, anëtarët e këshillit bashkiak, institucione të tjera që përfshihen në mbarëvajtjen e vitit shkollor, me qëllim që aty të parashtrihen, të diskutohen, të bihet dakord dhe të merren masa për një proces arsimor sa më të mirë të këtij viti, për të mos harruar dhe shumë prindër dhe nxënës, pse jo, që mund të kenë dëshirë të marrin pjesë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Mendim tjetër ka?

-Pjerin Ndreu: Edhe njëherë. Është tjetër koncepti i oficerit të sigurisë, është tjetër koncepti i rojes, është tjetër koncepti i marrjes së masave të sigurisë, është tjetër koncepti i rojes, pra çështja e rojes ndoshta nuk e zgjidh problemin e sigurisë, në disa vende, pra të marrësh rojen si pikë reference është banalitet, pra të thuash duhet roje aty, jemi tu fol për çështjen që është ngritë se janë çështje me të cilat marrin lekë njerëzit, po i marrin në mënyrë të paligjshme pra janë disa terma që i kemi trajtuar dhe vazhdojmë t'i trajtojmë, por duhet pranuar se në realitet ne nuk është se kemi gjendje alarmante, problematike që të shqetësohemi, kjo nuk do të thotë që mund të mos ndodhë, jam dakord, ndodh dhe në Amerikë me roje e pa roje, ndodh dhe në Europë, ndodh kudo, dhe ne e kemi zakon që po ndodhi atëherë oburra të gjejnë fajtorin para se me shëru situatën, me u mundu me e fshi, me lehtësu ato pasojat e traumës që shkakton një ngjarje, veç se me u marrë me popullatën me e qetësu, mos me e alarmu, i fusim në panik edhe e krijojmë sikur nesër do të ndodhin nja pesë ngjarje të tjera, mbasnesër nja 15 ngjarje të tjera, nja 25 ngjarje të tjera dhe e kemi kështu si modë këtë punë. Prandaj qasemi nga e mbrapshta ne, nuk qasemi nga e mbara, ne gjithmonë marrim negativitetin, e vëmë në plan të parë dhe mbi atë negativitet ne ndërtojmë gjithë fabulën, dhe nuk marrim gjërat pozitive dhe ata që ne prodhojmë dhe duhet të prodhojmë avash avash, do ta bëjmë, unë pranoj sugjerime po nuk pranoj raporte. As edhe një organizatë joqeveritare nuk ka tagër që të gënjejë donatorët me të dhëna të paqena, nuk ndodh, për diskutime po bëjmë, hajde si ta bëjmë e tek ta bëjmë, për në chatgpt i gjejmë të gjitha.

-Ndue Luli: Mendim tjetër ka? Nuk ka. Atëherë kush është dakord me projektvendimin duke cilësuar dhe ato ndryshime që i relatoi drejtori i arsimit sipas edhe rekomandimeve të qendrës H.A.N.A? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 22 vota Pro, faleminderit,

Diçka që më kaloi pak përpara pa thënë, kaluam tre projekt vendime që kanë të bëjnë me miratimin e planit vendor, për barazinë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen të romëve dhe egjiptianëve dhe për barazinë gjinore, ka një lapsus të vogël që nuk duhet neni 29, pra mbështetur projektvendimi te neni 29, por duhet neni 24, kjo është sa për dijeni, faleminderit.

Kalojmë te pika 7, Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025””.

Në lidhje me këtë ndryshim buxheti, fjalën e ka zoti Marku.

-Agostin Marku: Faleminderit. Komisioni i buxhetit në parim është dakord për kalimin e këtij projekt vendimi që ka të bëjë me ca rregullime brenda zërave buxhetore. Pra kemi të bëjmë me pakësime edhe shtesa tek investimet edhe pikërisht hiqen tek ato objekte të cilat nuk mund të mbyllen në mënyrë që të realizohet i gjithë fondi i investimeve i planifikuar për këtë qëllim, janë bërë zhvendosjet në disa të tjera që janë më të gatshme si nga ana procedurale edhe nga projektet, është shumë e rëndësishme të themi që është futur në projekt për 2026 edhe ndërtimi varrezave të qytetit, pikërisht bëhet edhe ky ndryshim pra parashikohet dhe ky dhe komisioni jonë është dakord ta kalojmë dhe ju ftoj që ta miratojmë, faleminderit.

-Ndue Luli: Mendim tjetër? Nuk ka, atëherë kush është dakord me projekt vendimin, ju lutem kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 22 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 8, Projekt-Vendim “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë “Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim dhe pa afat të objektit “CASA OLA”, në Lezhë në funksion të krijimit të Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor””

Edhe për këtë shkurtimisht kush e do fjalën se folëm pak përpara. Fjalën e ka kryetari.

-Pjerin Ndreu: Qendra CASA OLA ka qenë nën kujdesin e USAID që të jemi të qartë dhe në financimin e tyre nëpërmjet UNDP-së ndodhi ajo që ndodhi që ju e dini tashmë që USAID e ndërpreu komplet atë, kemi hyrë ne për ta mbajtur me fondet tona, ne mendojmë se edhe po që puna për QZHD-në do disa përshtatje, nuk na shkon përshtat për momentin ai vend, ne do t’ia japim qendrën sepse e financon ministria e shëndetësisë komplet dhe është një qendër që na mungon që është e vërteta në Lezhë, na mungon, në qoftë se flasim për një rrezik potencial të njerëzve që kanë probleme mendore, ne na duhet të akomodohen diku dhe të trajtohen, sepse nuk e kemi këtë, ndërkohë që ne po shikojmë pastaj edhe qendrat e tjera. Në qendrën e moshës së tretë ne kemi rënë dakord që do bëjmë edhe mensa ditore, mund të shohim deri në fund mund të akomodojmë ose të gjejmë një objekt tjetër që ta akomodojmë, presim një grup italian që don me ardhë të bëjë një qendër sociale shumë dimensionale këtu në Lezhë, unë mendoj se do kemi

takim shumë shpejt me ta dhe them që do e adresojmë, por për momentin në kushtet kur ne kanë ikur donatorët jo për fajin tonë kuptohet, se e merrni vesh ju, për shkak të një projekti atëherë jemi të detyruar që t'ia japim për një çështje që është për të sëmurët mendore, njerëzit me probleme mendore që në fakt janë rrezik potencial në komunitet.

-Ndue Luli: Mendim tjetër? Po zoti Marku.

-Agostin Marku: Unë dua të sqaroj diçka, kjo qendër vjen si pronë e bashkisë apo ka qenë pronë e bashkisë, ka qenë, jepet në përdorim, kujt i jepet, institucioni që i jepet a është nën juridiksionin e bashkisë, jo, atëherë, faleminderit për sqarimin.

E para, do të doja që kur jepet një e tillë, pavarësisht se ne nuk e tjetërsojmë por e japim në përdorim, por vetë fakti që jepet pa përcaktim, duhet që të shoqërohet edhe me çështjen e vlerës dhe inventarizimit, mendimi im, që vendimi të dalë më i plotë.

Së dyti, tek pika e dy e projektvendimit, unë e kam thënë disa herë dhe po e përsëris, e kam për drejtoritë e bashkisë, nuk është këshilli organit ekzekutiv, nuk ngarkon këshilli drejtoritë, drejtoritë i ngarkon kryetari i bashkisë, ne njohim kryetarin e bashkisë si titullar ekzekutiv të institucionit. Dhe ne ngarkojmë kryetarin e bashkisë, kryetari i bashkisë nxjerr urdhra, akte që të zbatohen vendimet e këshillit të bashkisë, ta keni edhe për herë të tjera në procese vendimmarrëse, jo drejtoritë, këshilli duke marrë kompetencat e kryetarit me përcaktim drejtoritë.

Pra e para ju sugjeroj që vendimi të dalë bashkëlidhur, vlera, çështje të tjera të inventarizimit e të tjera e të tjera, sepse është më transparente dhe shumë më mirë dhe për ju, sepse çlironi kontabilitetin. Dhe ky ndryshim, që ky propozim i dytë është propozim ligjor, faleminderit.

-Ndue Luli: Mendim tjetër, zonja Marku.

-Alfrida Marku: Unë mendoj që në këtë mbledhje duhet të ishin prezentë edhe përfaqësues të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë, pasi prej tyre do duhej që të merrnim disa përgjigje sa i përket shërbimit që do të ofrohet, sepse në projektvendimin që është paraqitur, nuk ka një sqarim të detajuar pikërisht mbi shërbimet që do të ofrohen. Unë kam disa pikëpyetje, por që nëse do ishin prezent përfaqësuesit e këtij institucioni, patjetër që do merrnim përgjigje. Pse është kaq emergjente që kjo qendër e kujdesit të shëndetit mendor pikërisht të akomodohet në këtë objekt? A nuk ka një zgjidhje tjetër më efektive? Sa raste ka pasur të personave që kanë nevojë për këtë trajtim të paktën në dy vitet e fundit? Si do të funksionojë kjo qendër? Pra, do marrin shërbim ditor apo do të funksionojë edhe si spital, nëse mund ta shpreh kështu. Edhe unë prapë i qëndroj propozimit që CASA OLA me një investim të duhur edhe simbolik do të ishte një zgjidhje shumë më e mirë dhe efektive nëse Bashkia Lezhë do të akomodonte aty qendrën e zhvillimit ditor. Por në kushte që ne kemi pikëpyetje sa i përket shërbimit që Njësia e Kujdesit Shëndetësor kërkon që të ofrojë në këtë qendër të rasteve të pritshme të individëve që mund të marrin shërbim në këtë qendër, në kushtet që përfaqësues të këtij institucioni nuk janë këtu prezentë, në një kohë që ne si këshill bashkiak marrim përgjegjësinë që t'u kalojmë në përdorim pa afat dhe pa shpërblim, një pronë të bashkisë të cilën mund ta vëmë në përdorim shumë më

mirë sesa në këtë mënyrë, por gjithmonë duke mos anashkaluar dhe domosdoshmërinë që ka gjetja e zgjidhjes për kujdesin ndaj personave që kanë probleme të shëndetit mendor, unë mendoj që ky projektvendim të lihet për diskutim dhe vlerësim nga këshilli bashkiak në një mbledhje tjetër me qëllim që edhe të shqyrtohet mundësia që është mënyrë më e mirë, është investim afatgjatë dhe më i duhur akomodimi i qendrës së zhvillimit ditor në ambientet e CASA OLA. Në vijimësi, me parashtrimin dhe sqarimin e situatës që do të marrim nga drejtues të Njesisë së Kujdesit Shëndetësor, pse jo të gjejmë edhe një zgjidhje urgjente dhe për këtë shërbim. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mendim tjetër? Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Se kur nuk e kanë lexuar, bën edhe pyetjen gabim. Identifikimi i hershëm i rasteve të sëmundjes me probleme mendore, diagnostifikimi kompleks i çrregullimeve mendore dhe rrethanave të tjera shëndetësore, vlerësimi i nevojave individuale për mbështetje dhe ndërhyrje të mëtejshme, mjekimi me barna dhe trajtim psikologjik, rehabilitimi psikosocial, pra më qartë se kaq. Unë e kam parë këtë, kjo ha diskutim. Edhe unë, për shembull, kam diskutuar me Marten, Marta s'është dakord. Unë mendoj se kjo është në kushtet kur ne jemi çorganizuar pak atje. Ne e mbajmë normalisht, nuk është se nuk e mbajmë, por unë mendoj se kjo kategori është komplet jashtë kontrolli sepse kur na ndodh një gjë, për shembull, që shkon njëri e mbyt nënën atje a tjetri shkon e del rrugëve e bëhet rrezik për fëmijët që dalin prej shkolle apo për komunitetin diku në një zonë të banuar apo për një gjë që bëhet rrezik që janë agresivë që për shkak të sëmundjeve mendore ne nuk kemi një qendër, nuk kemi një mënyrë se si do t'i trajtojmë, nuk e kemi sot dhe në qoftë se, për shembull, e kemi QZHD-në ashtu sikur e kemi, e kemi, normalisht duhet të jetë edhe më mire, jam dakord, mirë, në rregull, jam dakord, po këta s'i kemi fare të trajtuar, fare. Pak a shumë konvergojnë këto dhe me ata me zhvillim të vonuar, kanë sjellje agresive, kanë probleme, mundet disa t'i akomodojmë dhe këtu për shkak të përputhjes edhe për shkak të moshës që kapin. Pra, unë mendoj që ne nuk kemi pse refuzojmë një gjë që a shërben, bëhet fjalë, po shërben, a ndihmon në një kategori që për ne është pamenaxhueshme, edhe për një në shtëpi është e pamenaxhueshme, në shtëpi me e pasë ti s'e menaxhon dot, këtu të paktën merren, i identifikon, i vlerëson, i merr i çon atje, u jep trajtim mjekësor, u jep trajtim psikosocial, pra fillojnë disa faza. Kush do vijë po të njëjtën gjë do na thotë, se e kemi konsultuar ne me ta. Unë jam dakord, në qoftë se doni ta shtyjmë, çdo shtyrje ka të bëjë edhe me fondet e ministrisë që do japë ministria, do e shtyjmë ne, do e humbasim si projekt. Ne e kemi diskutuar këtë projekt, kemi pasur diskutime dhe të brendshme për këtë problem, po unë mendoj, e kam vlerësuar këtë si një kategori njerëzish që ne nuk i menaxhojmë as në shtëpi, as në shkollë, as në lagje, nuk i menaxhojmë askund, as prindi s'i menaxhon dot, as kërkush. Atëherë unë mendoj se më në nevojë se jemi me këta, nuk ka ndonjë kategori për momentin më në nevojë se këta. Edhe nga ana humane duhen trajtuar, duhen çuar në qendër, duhen të fillojnë të socializohen, të jepet ndonjë ndihmë diku dhe e kemi këtë mundësi sot. Janë pjesa më e pamenaxhueshme po themi dhe më e patrajtuar.

-Ndue Luli: Ka kush ndonjë mendim tjetër?

-Pjerin Ndreu: Problemi është këtu që, zonja këshilltare, ke punuar në bashki, jo çdo thënie e jotja është arsye për me marrë vendim ne. Ti ke një mendim me çu QZHD-në, unë s'kam mendim me çu QZHD-në atje, unë të dëgjova, sepse QZHD-në ne e kemi diskutuar që duhet të lëvizë prej aty, bie dakord me logjikën, por jo atje, sepse atje po bëjmë një mbjellje, nuk po mbjellim selvia, por po mbjellim një pemë tjetër, po mbjellim një pemë aty që në fakt a vlen, po vlen.

-Ndue Luli: Tani ne folëm për shumë problematika që ekzistojnë. Një nga problematikat që doli këtu ishte çerdhet e reja, po tani ne po marrim një ambient të cilin do ia lëmë në shërbim një pjese të shoqërisë, e cila për momentin vihet për mendimin tim, përpara çerdhes së fëmijëve, për vetë rrezikshmërinë që mund të paraqesë një i sëmurë mendor.

-Pjerin Ndreu: Më fal, një minutë, mund ta sqarojmë edhe këtë. Sot që flasim, po mbaron projekti i çerdhes së re te shkolla Kosova. Pra është në mes të qytetit. Thamë do ta bëjmë te Gurrat po aty thonë këta se s'është i përshtatshëm te pallatet e reja, kështu më thonë, kështu them edhe unë, atëherë çfarë do bëjmë, do e marrim me qera edhe do gjejmë një ambient të madh që të bëjmë një kopsht tjetër edhe çerdhja edhe kopshti, janë gjëra që janë adresuar dhe do bëhet edhe rikonstruksioni i kopshtit të lagjes Skënderbeg, fillon tani, pra nuk është se e kemi lënë pa e parë, jam dakord që duhet çerdhe, duhen dhe kopshte, por na ka gjet dhe kjo belaja e madhe që ne shtu kopshte, këto ardhjet nga njësitë administrative, atëherë do detyrohemi atë që tha Keleri që në këto njësitë e mëdha, në Shënkoll për shembull do shikojmë variantin, po s'po gjejmë objekt, se është edhe problemi i objektit, ku do e bëjmë, ta bëjmë të ri, e në disa zona për shembull që mund të kapet zona e Zadrimës diku, mund të bëjmë një projekt që t'i akomodojmë të përqëndruar, mund të bëjmë një kopsht me çerdhe dy katësh diku në vete, ndërkohë që jemi në proces të përmirësimit të kushteve të të gjitha dhomave të kopshteve, qoftë edhe një dhomë, dy dhoma në njësi të administrative të gjitha pa përjashtim komplet i kemi në proces, do shtrohen me parket, do bëhen me ngrohje e ftohje, do bëhen me mjete didaktike, me të gjitha çfarë duhet. Janë 39 kopshte që ne po i bëjmë në të gjitha njësitë administrative, ato që janë sot njëherë, të rikuperojmë situatën që kemi, se e kemi jashtë loje dhe ne kemi ndërhyrë, nuk është se s'po ecim, por duhet me shtu kapacitetet.

-Ndue Luli: E qartë, zonja Gjoni.

-Flutura Gjoni: Në lidhje me këtë projekt vendim kisha me i shtu pak asaj që tha Agostini, ky objekt ligjërish duhet të mbetet në pronësi të Bashkisë Lezhë, përpilohet një akt juridik, situata si është objekti edhe ekspozimi ndaj riskut, faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju. Atëherë kush është dakord me projekt vendimin duke bërë këto dy ndryshime të vogla, në fund të paragrafit të pikës së parë të shtohet sipas inventarit bashkangjitur, i cili do të përgatitet, kuptohet që të vijë kur të zbardhet vendimi, dhe pika dy jo ngarkohet drejtoria juridike e të tjera e të tjera, por ngarkohet kryetari i bashkisë ashtu siç janë gjithë projekt vendimet që vijnë këtu.

Miratohet me 21 vota Pro. Këshilltarja Alfrida Marku votoi Abstenim. Faleminderit.

Vazhdojmë me projektvendimin e fundit, “Për korrigjimin e VKB nr. 68, datë 29.07.2025 “Për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Rruga e Kishës” në “Motër Carmela Cataldo” dhe të marrë emrin “Nënë Karla Borgeri””.

Një sqarim këtu nga ana ime, është bërë një lapsus në muajin e kaluar te emërtimi kështu që bëhet fjalë vetëm për ndryshim emri, asnjë gjë tjetër s'ka, është gjithë dokumentacioni që ka sjellë njësia e Shënkollit, gjithë komuniteti atje.

Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 22 vota Pro, faleminderit.

Kalojmë te pika tjetër, informacion nga Bashkia Lezhë për realizimin e buxhetit për 7-mujorin e vitit 2025, informacion i cili është në dorën e secilit, kush do ketë ndonjë diçka për të, i japim fjalën, atëherë fjalën e ka zv/kryetarja e bashkisë.

-Brikena Vuksani: Përshëndetje të gjithëve. Siç edhe çdo muaj ne sjellim informacionin për leximin e buxhetit sipas treguesve dhe sipas të ardhurave dhe shpenzimeve që realizohen gjatë muajit, realizimi i buxhetit gjatë 7-mujorit të këtij viti, të ardhurat janë në masën 59.2% në bazë të 7-mujorit, ndërsa si realizimi i të ardhurave në raport me planin e vitit 2025, 12-mujor është 34%. Kryesisht kemi ecur me ritme të mira për realizimin e të ardhurave tek taksa e ndërtesës, taksa mbi pasurinë dhe taksa mbi tokën bujqësore apo dhe me tarifa të tjera. Dy taksat të cilat nuk kanë rezultatin sipas planifikimit të 7-mujorit janë taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, e cila gjatë 4-mujorit, këtij 4-mujorit që vjen do të arrijë në nivelet e parashikuara, gjithashtu dhe taksa e fjetjes në hotele, për të cilën janë dërguar faturat për hotelëritë gjatë muajit gusht dhe presim që gjatë muajit shtator të ketë rritje të nivelit të arkëtimeve në bazë të planit siç kemi parashikuar, gjithashtu dhe për shpenzimet kemi realizimin e shpenzimeve në masën 43.8%, kryesisht janë realizimi i shpenzimeve për pagat që kanë peshën më të madhe 77%, realizimi i shpenzimeve të tjera është 41% edhe realizimi i shpenzimeve kapitale është në vlerën 12%. Realizimi i shpenzimeve në këtë masë nuk do të thotë që shpenzimet nuk janë kryer ose investimet ose puna nuk është bërë, të gjitha sipas buxhetit që kanë qenë kanë përfunduar janë prokuruar janë lidhur kontrata dhe puna në terren ka filluar vetëm për pjesën e faturimeve ose mbledhjes së dokumentacionit janë gjatë fazës shtator-tetor që do të përfundojmë.

-Ndue Luli: Mendim tjetër?

-Pjerin Ndreu: Të bëjmë edhe një sqarim. Kryesisht është taksa e infrastrukturës që na ka shtyrë në kohë se nuk është problemi i rrezikut, janë 10 leje ndërtimi që duhet të zbardhen brenda këtij 2-3 mujori edhe ne ka rrezik bile që e kalojmë parashikimin, kuptohet se është edhe, se harroi Brikena, niveli i dytë i taksave, pjesa e dytë që biznesi e sjell në shtator, tani deri në fund të shtatorit, taksa e fjetës në hotel pastaj që normalisht është përmbyll tashti dhe do të vijnë gjithë ta paguajnë, edhe në gjithë ato planizime që kemi bërë kemi shku gati në 80-90 % të prokurimeve, tani gjenerimi i faturave nuk është në dorën tonë sepse është në dorën e zbatimit, ndoshta disa

fatura do gjenerohen mbas janarit, është problem, rëndësi ka që është në proces, do hapet thirrja shumë shpejt për rrugët urbane, që ne do fillojmë punë besoj deri në qoftë se shkon ashtu sikur duhet me shku po varet se e do atë kohën e vet, po unë po supozoj nëntor dhjetor ne fillojmë me rrugët urbane të qytetit, ndërkohë që KFË-ja fillon me kanalet e ujrave të zeza e të bardha, përfundimisht në shtator fillojnë, kanë bërë gati projektet nga lagjja e spitalit e poshtë. Ne hyjmë pastaj te varrezat publike, po fillojmë këto ditë, domethënë shpallet procedura na është dashur të bëjmë disa studime aty, se është folur në facebook për studim gjeologjik. Po si mund të bëjmë ne varreza pa studim gjeologjik, unë s'e kam s'e kuptoj, se këta rrinë në shtëpi edhe fantazojnë, fantazitë pa lekë janë edhe i lëshojnë kështu. Do hapim procedurën, meqënëse e ka përzemër zonja Dedgjonaj (Marku), të pallatit të tërmetit, do të adresohet. Jemi duke adresuar një kërkesë në KSJR përfundimisht, që të gjithë të 50 shtëpitë individuale që kanë ngelë, sa na la karitasi, e sa na la firma, ne të bëjmë një rialokim fondi duke bërë një përlllogaritje me manualin e ri që normalisht ka ndryshime çmimesh nga ai i vjetri dhe jemi të detyruar me hy dhe do i themi ministrisë së rindërtimit 800 milionë me të vjetra na i ke dhënë ti, na lejo ne që të shtojmë në bazë të manualit të një përlllogaritje të shtojmë ne fondin si bashki se nuk kemi zgjidhje tjetër dhe ne duhet t'i bëjmë ato shtëpi e të marrë fund kjo çështja e rindërtimit, mos të merremi më me këtë histori dhe ma merr mendja se brenda vitit ne do e kemi gati edhe këtë që të hapim procedurë që ta bëjmë, kështu që nuk ka asnjë rrezik fare, keni diskutuar këtu për 4-mujorin e parë, nuk ka një bashki që realizon të ardhurat në 4-mujorin e parë, ne na lirohet buxheti në mars ju e dini këtë punë, taksat paguhen në fund të qershorit i kemi shty ne hajde në fund të qershorit dhe me 30 qershor bëhet një bilanc se sa kanë paguar. Taksa e infrastrukturës nuk është një taksë që e bëjmë sot dhe nesër e marrim por projektioni me AZHT-në, jemi në fazën e zbardhjes tani, jo zbardhjen e miratimit, jemi të zbardhjes edhe tani këta ndërtuesit nuk çojnë një letër, nuk kanë të pasqyruar mirë një pronë, duhet të marrin një gjë, kanë disa andralla që duke i plotësuar dhe ne, por rrezik nuk kemi, përkundrazi vitin tjetër shkon edhe më rëndë kjo punë se e para rritet çmimi i referencës nga shteti, paguajnë më shumë dhe plus që ato projekte që janë duke u bërë s'kemi rrezik të madh financiar, problemi është si do t'i adresojmë këto lekë, si do i administrojmë, çfarë do bëjmë, do të flasim këtu në këshill, kur të vijmë me buxhetin, unë mendoj që bashkë me qeverinë të hyjmë në rrugë rurale, këtu bëhet me një plan që ne do të bëjmë një plan të përgjithshëm tani që ta adresojmë në masë, do marrim njësinë Blinisht në dorë ta bëjmë komplet, Kallmetin, komplet Dajçin, Zejmenin me rradhë, komplet, në Ungrej do ndërhyjmë, jemi me disa projekte në Ungrej, por do ndërhyjmë edhe në Ungrej, do mundohemi të shkojmë edhe atje me rrugë aty ku duhet, po step by step.

-Alfrida Marku: Një ndërhyrje të vogël meqë jemi te buxheti edhe ky vit solli diçka të re sa i përket menaxhimit të plazheve publike edhe në mbledhjen e muajit mars ndër të tjera ne kemi miratuar edhe rregullat e menaxhimit të hapësirave publike të plazheve ku gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje kuptohet një pjesë e këtyre hapësirave ishin falas për qytetarët, ndërkohë një pjesë tjetër e këtyre hapësirave publike të plazheve ishin me pagesë, me tarifat që pushues, vizitorë janë të njohur tashmë. Unë kisha një pyetje për drejtuesit e Bashkisë Lezhë, nëse kemi një raport paraprak të të ardhurave të siguruar nga kjo mënyrë re e menaxhimit të plazheve publike, në

mos, në mbledhjen e radhës, unë mendoj që këshilli bashkiak ka gjithë të drejtën që të informohet nga ana e Bashkisë Lezhë. se jo vetëm në aspektin e menaxhimit, si ka funksionuar kjo mënyrë e re, por në aspektin financiar, pra në të ardhurat e Bashkisë Lezhë, si ka ndikuar kjo mënyrë e re e menaxhimit të plazheve publike dhe unë mendoj që në mbledhjen e radhës, pse jo të njihemi edhe me drejtuesit e subjektit që i është deleguar kompetenca për të menaxhuar plazhet apo edhe me asamblenë apo bordin drejtues të këtij subjekti. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Tashti e kalove pak kompetencën, po ne jse. Për aspektin financiar, po jua them paraprakisht, ne sivjet kemi investuar në mjete, pra duke qenë se investuam në mjete, normalisht dalim me fitim, siguro që ta dini. Por normalisht, sivjet e kemi llogaritur që, domethënë, ndërsa blejmë mjete atje, ne sivjet llogaritëm zerimin. Pastaj, vitin tjetër duke i pasur mjetet nuk blejmë më mjete dhe e kalojmë në fitim. Pra, nuk është thënë që vitin e parë ne duhet të jemi uau. E dyta gjë që ka ndodhur është kjo, që njëherë ka qenë një vështirësi kuptimi te njerëzit se si do funksionojë kjo gjë. Te subjektet, subjektet kanë besuar deri në fund se mund të bëjnë çfarë të duan me këtë histori. Pra, kemi pasur lloj-lloj historish që më në fund pothuajse, le të themi, mbi 95% të rasteve i kemi në kontroll. Ajo që ka bërë përshtypje kësaj radhe, po ta shikoni, domethënë ne i kemi dhënë mundësi në disa pika pushuesve që të shkojnë me zero lek, të shkojnë ose me shifra që kemi vënë ne. Çuditërisht i kanë frekuentuar pak. Tani bosh kanë qenë, e kemi filmuar disa here me dron, pjesa publike bosh. Si duket ajo psikoza, ai halli i madh që po shkova unë atje më quajnë pabuks, që ndodh në Shqipëri e kanë merak, më mirë shkojnë paguajnë atje. Pastaj ne kemi hyrë në marrëdhënie me disa stacione plazhi ku i kemi imponuar çmimin nëse ti do me e marrë, do me e menaxhu me shezllone e kemi imponu çmimin ne, filluan duke abuzu.

Gjithsesi ka shkuar me fitim, por vitin tjetër, ne nesër kemi një takim me kryeministrin, kryeministri na ka çuar një projekt ide që ia ka dhënë dikush, me të thënë të drejtën mua më pëlqeu pafund, ndoshta do bëhet një skenar tjetër, që qeveria të ndërhyjë, ndoshta thashë, të ndërhyjë bashkë me bashkitë që komplet shërbimin ta marrë bashkia totalisht, edhe ti si hoteleri nuk mundesh me e marrë e me e dhënë sa të duash, do ta marrësh me çmimin tim, do ta japësh, do ta marrësh për klientelën e do ta paguash në çmim dhome te bashkia, kaq, por nëse do ta japësh për jashtë klientelës se të ngelin 10 bosh do ta japësh me çmimin që ka bashkia, ndryshe ose qeveria do të disponohet me aktin normativ që ka të ndryshohet dhe ta detyrojë subjektin që ti s'mund të japësh në zonën ku ka bashkia referencë mbi referencë çmim pikë nëse e jep të heq shezllonet komplet, shërbimin, pra këtë punë do ta rregullojmë besoj, plus edhe një gjë tjetër që ta dish, ky ishte viti i fundit i kontratave pesëvjeçare, pra vitin tjetër pothuajse zona e Kunes zbrazet, se nuk ka më kontrata pesëvjeçare, pra zbrazet e kalon në publike komplet,

Raporti financiar do të vijë, kur të duash ti me Brikenën shkoni atje. Drejtori do vijë këtu edhe është bilbil nga goja, edhe jua shpjegon me detaje,

-**Ndue Luli:** Faleminderit, kush ka ndonjë problem tjetër? Jemi te pika “Të ndryshme”, fjalën e ka zoti Pjetër Gjinkola.

-**Pjeter Gjinkola:** Kam një shqetësim në lidhje me rrugën, u bë rruga e Velipojës, por për Shëngjinin u kthy në bumerang për arsyen e parkimeve. Tani me mbylljen e sezonit çfarë do bëhet, do ketë ndonjë ndërtim aty?

-**Pjerin Ndreu:** Bajpasi i Shëngjinit është mbyllë si histori, pra fillon këto ditë puna, e dyta rruga Milot-Balldren, është hapë thirrja që me datën 2 gusht dhe besoj se brenda këtij viti mbyllën procedurat, po le të supozojmë se në tetor hapen ofertat, është adresuar, do bëhet ura e Milotit për mjetet e lehta dhe unë besoj se me Milot-Balldrenin ne do bëjmë një akord që njëri krah i tunelit dhe njëri krah i rrugës të bëhet shpejt domethënë të operojmë më shpejt në një krah njëherë pastaj të bëhet krahu tjetër.

Parkingu nëntokësor është miratu, pra është adresu si problematikë dhe po bëhen ato kalkulimet dhe Lezha ka nevojë për parking nëntokësor. Me adresimin e ujrave të bardha e të zeza, ne heqim problemin e përmbytjeve, që me një orë shi përmbytet qyteti, atëherë bëjmë parkingun nëntokësor, na duhet një park, pedonalja lidhet me parkun, me parkingun dhe krijohet një zonë shumë atraktive që i mungon Lezhës. Dhe ne kemi projektet.

-**Ndue Luli:** Mendim tjetër ka kush? Nuk ka.

Para se ta mbyllim, duhet ta dimë ne si këshilltarë se jemi në prag të fazës së dytë të diskutimit të projekt buxhetit, jo vetëm për vitin 2026, por edhe atij afatmesëm 2026-2028. Është e mira gjithmonë që ne si këshilltarë të jemi prezent gjatë këtyre konsultimeve dëgjësave publike.

Ju falenderoj për pjesëmarrjen, për mendimet dhe sugjerimet që patët.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Florida Çunaj


KRYETARI

NDUE LULI
